



Pranuar / Dorezuar Primjeno/Prodato Received/Delivery	23.12.2021	viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHK	6308/2021		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A.nr.954/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti -anëtarë, si dhe Zyle Millaku Gojnovci, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, bazuar në Aktgjykimin A.nr.3027/19 të datës 23.11.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.823/2018 të datës 12.12.2018 të parashtruar nga ankuesi me adresë Rr. "Pehar Begolli", pa numër Veternik në Prishtinë, kundër organit të punësimit të Administratës Tatimore të Kosovës, në çështjen juridike „kërkesë nga marrëdhënie pune”, duke vepruar në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 22.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa A.nr. 823/2018 e datës 12.12.2018 të parashtruar nga ankuesi

II. MBETET në fuqi Vendimi me numër protokollit 11/134 i datës 07.12.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi sipas shkresave të lëndës i punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës, me datë 14.11.2018 ka parashtruar kërkesë me numër protokollit 12-06-3956 për lejimin e angazhimit në punë dytësore në institucionin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës në cilësinë e "Ekspertit Gjyqësor", duke bashkangjitur edhe aplikacionin dhe kërkesën për punë sekondare-aktivitet jashtë Administratës Tatimore të Kosovës, në Divizionin e Standardeve Profesionale të Administratës Tatimore të Kosovës.

Divizioni i Standardeve Profesionale në Administratën Tatimore të Kosovës, me datë 15.11.2018 ka nxjerrë vendimin me numër të protokollit 04-06-3967 me të cilin ka refuzuar kërkesën me numër të protokollit 12-06-3956 të datës 14.11.2018, sipas formës "Aplikacionit të kërkesës për punë sekondare-Aktivitet jashtë ATK-së" për t'u angazhuar në punë sekondare në cilësinë e "Ekspertit Gjyqësor" në Këshillin Gjyqësor.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin e datës 15.11.2018 të Divizionit të Standardeve Profesionale të Administratës Tatimore të Kosovës, më datë 15.11.2018 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 11-06-3981 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Administratën Tatimore të Kosovës.

Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Administratën Tatimore të Kosovës, më datë 07.12.2018 ka nxjerrë Vendimin me numër të protokollit 134 me të cilin ka e refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar dhe ka lënë në fuqi vendimin e Divizionit të Standardeve Profesionale me numër 04-06-3967 të datës 15.11.2018.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin e datës 07.12.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës, ka parashtruar ankesë me datë 12.12.2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër të protokollit 7588/2018.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 19.12.2018 e ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Administrata Tatimore të Kosovës, e cila me datë 27.12.2018 e ka dhënë përgjigje në ankesë tek Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 21.01.2019 ka nxjerrë Vendimin me nr. protokollit 318/2019 i regjistruar me A.nr.823/2018, me të cilin është shpallur jo kompetent për të vendosur për ankesën e ankuesit të cilin vendim ankuesi e ka pranuar me datës 24.01.2019 sipas fletë-kthesës. Ndaj të cilit vendim ankuesi ka parashtrua kërkesë padi me datë 07.02.2019 në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, e cila me datë 23.11.2021 ka nxjerrë Aktgjykimin me numër A.nr.359/19, me të cilin ka aprovuar kërkesë padinë e ankuesit duke anuluar vendimin e Këshillit dhe lëndën e kthen në vendosje, për të vendosur për ankesën e ankuesit të datës 12.12.2018 me numër A.nr.823/2018.

Kolegji për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Aktgjykimin me numër A.nr.359/19 i Gjykatës Themelore-Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë; Vendimi i datës 21.01.2019 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me nr. protokollit 318/2019 i regjistruar me A.nr.823/2018; fletë kthesa e datës 24.01.2019; Ankesa me numër A.nr.823/2018 me numër protokollit 7588/2018 të datës 12.12.2018 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 07.12.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës; Aplikacionin i kërkesës për punë sekondare-aktivitet jashtë Administratës Tatimore të Kosovës; Vendimi i datës 11.01.2017 nga Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës; Akt emërimi datës 11.03.2012; Vendimi i datës 15.11.2018; Ankesa e ankuesit e datës 15.11.2018 e parashtruar në Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Administratën Tatimore të Kosovës si dhe përgjigjja në ankesë e Administratës Tatimore të Kosovës e datës 27.12.2018.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkëngjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e pa bazuar sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtua pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon anulimin e Vendimit Nr. 11/134 të datës 07.12.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës, dhe të lejohet puna sekondare-aktiviteti, në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, për vendin e punës "Ekspert Gjyqësor", në Gjykatën

Komunale në Prishtinë, jashtë Administratës Tatimore të Kosovës, sepse kjo pozitë nuk pengon natyrën e punës dhe nuk bije ndesh me natyrën e punës.

Kolegji në bazë të shkresave të lëndës, ka konstatuar se ankuesit me datë 15.11.2018 i është refuzuar kërkesa e datës 14.11.2018 drejtuar Divizionit të Standardeve Profesionale në Administratë Tatimore të Kosovës, për lejitim e punës sekondare-aktiviteti, në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, për vendin e punës “Ekspert Gjyqësor”, në Gjykatën Komunale në Prishtinë, jashtë Administratës Tatimore të Kosovës, i cili vendim është nxjerrë në pajtim me nenit 16 paragrafit 4 të Rregullores(QRK)Nr.04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se: **“ Angazhimi i nëpunësit civil në kuadër të veprimtarive sindikale ose të përfaqësimit të nëpunësve civil ose veprimtaritë mësimdhënëse, hulumtuuese dhe trajnuese, janë të lejueshme kur ato nuk pengojnë në kryerjen e detyrës dhe nuk bien ndesh me natyrën e punës”**, i cili po ashtu është bazuar në Vendimit Nr.protokolli 11-06-92 të datës 11.01.2017 të nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, i cili vendim ndalon angazhimin në e punë sekondare jashtë Administratës Tatimore të Kosovës, i cili është bazuar në Kodin i Etikës dhe Mirësjelljes së Zyrtarëve në Administratën Tatimore, për të gjithë zyrtarët e Administratës Tatimore të Kosovës, duke arsyetuar se angazhimet e tilla jashtë rregullave të punësuarve në Administratën Tatimore të Kosovës, bijën ndesh me shkeljet serioze të detyrave të punës, bazuar në dispozitën ligjore të nenit 6 të Rregullores Nr.04/2011 mbi procedurën Disiplinore në Shërbimin civil të Kosovës.

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Vendimi Nr.07.12.2018 i nxjerrë nga Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Administratën Tatimore të Kosovës, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, me të cilin ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, me rastin e refuzimit të ankesës së ankuesit i cili pretendon që ti aprovohet kërkesa e datës 14.11.2018 nga Divizioni i Standardeve Profesionale në Administratë Tatimore e Kosovës, për lejitim e punës sekondare-Aktiviteti, në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, për vendin e punës “Ekspert Gjyqësor”, në Gjykatën Komunale në Prishtinë, jashtë Administratës Tatimore të Kosovës, duke marrë për bazë dispozitat ligjore të Vendimit Nr. Protokolli 11-06-92 të datës 11.01.2017 të nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, dhe pretendimet ankimore të ankuesit janë të pa bazuar sipas dispozitave ligjore të përcaktuara në Vendimin Nr. Protokolli 11-06-92 të datës 11.01.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm në Administratës Tatimore të Kosovës.

Kolegji konstaton se nëse ende qëndron interesi i palës ankuese për punë sekondarë jashtë ATK-së duhet të marr edhe mendimin e Agjensionit Kundër Korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit, nëse puna në ATK dhe angazhimi ne si ekspert gjyqësor a përbejnë konflikt interesi, prandaj është i nevojshëm gjithsesi edhe ky institucion të jep mendimin e tijë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Administratën Tatimore të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.07.12.2018 të i datës 07.12.2018, ka vepruar në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda Nr. A nr.954/2021

Zyle MILLAKI GOJNOVCI

procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm në Administratën Tatimore të Kosovës;
- Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, për Gjyqtarin Fisnik Nuli,
- Udhëheqësit të Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK.